

Tiranë më 06 / 07 /2026

KËRKESA PËR SHTYRJEN E SEANCËS GJYËSORE

(në vëmendjen e gjykatëses Elsa Ulliri)

KËRKUES: E pandehura Ajola XOXA, atësia Arben, amësia Valbona, e dtl 16.07.1983, lindur e banuese në Tiranë, me adrese për efekt te njoftimeve Njësia Bashkiare Nr.5, Rruga “*Ibrahim Rugova*, Sky Toëer, Kati10/4, Tiranë përfaqësuar nga Av. Prof. Dr. Maksim HAXHIA dhe Av. Gurali BRAHIMLLARI me adresë postare: Blv “*Dëshmorët e Kombit*”, Kullat Binjake, hyrja kryesore, Kat i III-të,
TIRANË

OBJEKTI: Kërkohet shtyrja e seancës gjyqësore dhe pezullimi i shqyrtimit gjyqësor sipas raportit mjekësor pas lindjes së fëmijës

BAZA LIGJORE: Nenet 31/ç; 42 dhe 54/1 të Kushtetutës dhe Neni 350/1 i K.Pr.Penale
Nenet 26, 27/2 të Ligj nr. 7703, dt 11.05.1993 *Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*” dhe Nenet 104 i Kodit të Punës

E nderuara znj. Kryesuese!

Të nderuara antarë ët trupës gjykeuse!

Në kushtet kur, unë e pandehura Ajola Xoxa, për shkakë të gjendjes shëndetësor të krijuar pas lindjes, e kam të pamundur pjesëmarrjen fizike në seancat gjyqësore që, sipas njoftimit të mbrojtjes në një nga seancat e zhvilluara në muajin maj Ju keni vendsour të çvillohen çdo ditë të martë në orën 10:00.

Ju bëj të ditur se në gjendjen shëndetësore që kam para datës 29 Qershor 2026 dhe gjendjes aktuale pas lindjes me operacion (prerje cezartiane) **nuk mund komunikojë lirshëm dhe privatisht me mbrojtësit** e zgjedhur prej meje, prandaj nuk mund te garantohet prej tyre mbrojtja efektive në gjykimin e çështjes ën themel.

Në këto rrethana, bazuar në parashikimin e nenit 350/1 të K.Pr.Penale, kërkoj shtyrjen e seancës gjyqësore dhe caktimin e një seance, në përputhje me afatin e paafëtisë në punë që parashikon raporti mjekësor sipas parashikimeve të kodit të punës, ligjit për sigurimet shëndetësore dhe garanton Kushtetut për të drejtat e nënës pas lindjes së një fëmije si vijon :

KODI I PROCEDRUËS PENALE

Neni 350/1: *1. Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim viktime akuzuese, nuk paraqitet në seancë dhe del se*

mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia, gjykata, edhe kryesisht, shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja.

KUSHTETUTA :

Neni 31 Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- c) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;*

Neni 54 *1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.*

KODI I PUNËS:

Neni 104 *1. Ndalohet puna për gratë shtatzëna 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes. ..*

LIGJI NR. 7703, datë 11.05.1993 Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë

Neni 27 E ardhura për barrë lindje:

- 1. E ardhura për barrë lindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përjashtohet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrë lindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm;*
- 2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijëve;*

Sa më sipër, në këte sitatë faktike kur provohet pamundësia objektive për të marrë pjesë dhe për të realizuar mbrojtje efektive, duke besuar se Gjykata do të mbajë në konsideratë, parashikimet e dispozitave të mësipërme ligjore, kërkoj që të shtyni seancën gjyqësore, duke e pezulluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes, për periudhën e paracaktuar nga ligji në lidhje me drejtën e çdo NËNE, PAS LINDJES SË FËMIJËS dhe që garantohet nga nenet 31/ç dhe 54/1 të Kushtetutës .

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

Me respekt e konsiderate

Ajola Xoxa

Bashkëngjitur do të gjeni:

- 1. Raportin mjekësor**
- 2. Çertifikate e lindjes e djalit**